



EDUKIMI MJEDISOR



Dhjetor 2023

Edukimi mjedisor natyror i ndihmon nxënësit të njihen me çështje të rëndësishme dhe jetike mjedisore si: ujin, ajrin, tokën, natyrën, biodiversitetin. Edukimi mjedisor është veprimtaria akademike dhe praktike, që përfshinë studimin sistematik të mjedisit dhe gjithë marrëdhënieve që e shoqërojnë; përmes vëzhgimeve dhe eksperimenteve. Përgjatë tyre nxënësit përfshihen emocionalisht dhe fizikisht; ata mësojnë për zgjidhjen e shqetësimeve dhe problematikave të ndotjes, mbetjeve, energjisë, ekonomisë qarkulluese dhe, mbrojtjen e dashurinë për natyrën.

“Të diturin e pasuron natyra”

Epikuri

Mentorët e tyre, të cilët janë specialistët e edukimit mjedisor në 12 AdZM-të e vendit mbështesin, përfshijnë dhe ndërmarrin nisma të përbashkëta me nxënësit, për përmirësimin e mjediseve të ndryshme. Në sajë të këtyre veprimtarive ata zhvillojnë shprehje dhe dije mjedisore, që i bëjnë të veprojnë në mënyrë të përgjegjshme e të mençur. Përmes edukimit mjedisor nxënësit e niveleve të ndryshme akademike përfitojnë:

vetëdije dhe ndërgjegjësim për mjedisin dhe sfidat mjedisore

kuptojnë dhe analizojnë probleme dhe çështje shqetësuese mjedisore

motivohen dhe përfshihen për përmirësimin e cilësisë së mjedisit në nivel lokal dhe kombëtar

ndërmarrin nisma dhe veprimtari që synojnë mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit



Përmes kësaj përmbledhjeje mujore Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura paraqet aktivitetet e zhvilluara nga 12 Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura, përgjatë muajit dhjetor 2023, me nxënësit e shkollave të ndryshme në mbarë vendin; atyre që ndodhen pranë ZM-ve, në zonat rurale. Aktivitete janë zhvilluar në kuadër të ditëve mjedisore, promovimit të zonave të mbrojtura, lojërave të ndryshme edukative dhe argëtuese në mjediset e shkollave apo në natyrë, duke synuar gjithëpërfshirjen e nxënësve të të dy gjinive, niveleve të ndryshme ekonomike dhe vendndodhjen gjeografike.

Nxënës të
përfshirë **780**

37 Shkolla të
përfshira

Specialistë të
angazhuar **12**

2 Universitete të
përfshirë

Orë mjedisore
të realizuara **39**



“EDUKIMI MJEDISOR”, SHKODËR



05 09 11

5 dhjetor 2023, Dita Ndërkombëtare e Tokës

Së bashku me nxënës të shkollës së Mesme të Bashkuar "Lucë Agraja" Dajç, pjesë e Peizazhit Ujor Tokësor të Mbrojtur "Lumi Buna - Velipojë" zhvilluam një aktivitet sensibilizues pastrimi në oborrin e shkollës dhe mjedisëve përreth saj.

9 dhjetor 2023, aksion pastrimi në brigjet e Bunës

Stafi i AdZM Shkodër në bashkëpunim me Well Point, Natyralistët, River Cleanup Albania, vullnetarë të rinjë dhe natyralistë të vegjël nga qyteti i Durrësit, zhvilluan një aksion pastrimi, në brigjet e Lumit Buna, pjesë e Peizazhit Ujor Tokësor Lumi Buna -Velipojë si dhe RNM Liqeni i Shkodrës.

11 dhjetor 2023, Dita Ndërkombëtare e Maleve

Zhvilluam një orë mjedisore me studentë të degës Biologji-Kimi në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi". Qëllimi i kësaj ditë është një mundësi për të rritur ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e maleve në jetën tonë dhe rolin e tyre në ekosistem.



5 dhjetor 2023, Dita Ndërkombëtare e Tokës

Në kuadër të "Dita Botërore e Tokës/Dheu" specialistët e AdZM Berat zhvilluan një orë edukimi mjedisor në shkollën "Mehmet Qypri" Rroshnik. Disktuam rreth temës, duke ndarë mesazhin se: "toka dhe ekosistemet e saj na sigurojnë jetë dhe ushqim, ruajtja e saj është e rëndësishme për një të ardhme të qëndrueshme".

11 dhjetor 2023, Dita Ndërkombëtare e Maleve

Në kuadër të "Dita Ndërkombëtare e Maleve" specialistët e AdZM Berat zhvilluan një orë edukimi mjedisor në shkollën "1 Maji", për rëndësinë e maleve dhe biodiversitetit dhe roli që kanë në cilësinë e jetës së njerëzve. Janë prezantuar foto dhe video nga Parku Kombëtar "Mali i Tomorrit" duke treguar burimet e tij të larmishme, florën, faunën, sipas eksperiencave të gjithësecilit.

18 dhjetor 2023, Orë mjedisore

Specialistët e AdZM Berat realizuan një orë mjedisore edukative me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Zihni Toska". Me nxënësit demonstruam përmes pikturave artistike, se ajo çka po i bëjmë mjedisit dhe pyjeve, është një pasqyrë se çfarë po i bëjmë vetes dhe njëri-tjetrit. Nxënësit përcollën urime dhe mesazhe për një vit me sa më shumë hapësira të gjelbra, duke e konsideruar vitin e ardhshëm 2024 si Viti i Blertë.

“EDUKIMI MJEDISOR”, DIBËR



9 dhjetor 2023, Orë mjedisore

Me anë të erozionit, transformimit të tokës dhe pyjeve gjatë viteve ju treguam nxënësve të shkollës “Maqellarë” se cila është mënyra më e mirë e mbrojtjes së tokës. Në fund të orës mjedisore demostruam mbjelljen e disa fidanëve.

15 dhjetor 2023, Orë mjedisore

Me anë të një prezantimi informuam nxënësit e shkollës “Burrel” rreth parqeve dhe zonave të mbrojtura.

20-24 dhjetor 2023, “Unë ricikloj”

Gjatë kësaj jave së bashku me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Idriz Kaba” kemi realizuar disa aktivitete me temë “Unë ricikloj”. Nxënësit me anë të materialeve të riciklueshme përgatitën objekte të ndryshme, që mund të përdoren nga vetë ata. Në fund nxënësit zbukuruan pemën e vitit të ri 2024, si dhe përgatitën kartolina, përmes të cilave përcollën mesazhe urimi për njëri-tjetrin.



“EDUKIMI MJEDISOR”, DURRËS



5 dhjetor 2023, Dita Ndërkombëtare e Tokës

Në kuadër të Ditës Botërore të Dheut specialistë të AdZM-së Durrës zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Pal Zefi " në Rrushkull. Aktiviteti u zhvillua në kopshtin e shkollës, ku nxënësit u njohën virtualisht mbi mënyrën e përpunimit dhe plehërimit të tokës. Gjithashtu, së bashku me nxënësit mbollëm disa fidanë akacie dhe plep.

11 dhjetor 2023, Dita Ndërkombëtare e Maleve

Në Ditën Ndërkombëtare të Maleve specialistë të AdZM Durrës zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Mustafa Myrteza Kaçaçi" në Krujë. Nxënësit u njohën me vlerat natyrore, faunën dhe florën e PN Qafështamë.

22 dhjetor 2023, Festa të blerta

Në kuadër të "Festave të Blerta" specialistë të AdZM Durrës zhvilluan një aktivitet me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Zenel Qazim Tepshi " në Krujë. Me shumë dashuri, fëmijët krijuan kartolina për mësueset, bredha dhe lule, ku përdorën materiale të riciklueshme.



5 dhjetor 2023, Dita Ndërkombëtare e Tokës

Në kuadër të Ditës së Dheut, së bashku me nxënësit e Shkollës 9-vjeçare “Gërmenj” zhvilluam një aktivitet ndërgjegjëses mjedisor. Fillimisht u zhvillua një diskutim për mënyrat e mbrojtjes së tokës dhe, më pas nxënësit me ndihmën e shoqatës Vento di Terro morën pjesë në një proces të analizave të Tokës pranë laboratorit UrbanLab. Nxënësit u njohën me laboratorin dhe metodologjinë e marrjes së mostrës së dheut, deri në përfundimin e analizave. Interesimi nga nxënësit ishte i madh duke qënë se janë edhe banorë të zonës.

22 dhjetor 2023, Orë mjedisore

Nxënësit e Shkollës Jopublike “Hafiz Ibrahim Dalliu” u informuan pranë Qendrës së Vizitorëve, për vlerat e parkut. Më pas ata njohën pelikanin kaçurrel, Xhoni.

23 dhjetor 2023, Orë mjedisore

Stafi i AdZM Fier së bashku me një grup studentësh të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, dega “Guidë Turistike Shqiptare dhe Menaxhim Sipërmarrje Turistike” nën udhëheqjen e Lektore Dr. Nevila Çina, markuan shtegun e kullës së Kanalit të Vaut, ku dhe mblodhën mbetje të lëna nga vizitorët që kanë frekuentuar parkun. Shtegu përdoret më së shumti nga vizitorët që frekuentojnë Lagunën e Karavastasë për vërtetimin e shpendëve. Në përfundim të markimit të shtegut u realizua Birdwatching. Studentët vërtetuan disa nga shpendët e parkut si flamingot, pelikanët, çafkat, karabullakët etj.

“EDUKIMI MJEDISOR”, KORÇË



Mjedisi mund të jetojë pa ne,
por ne jo pa mjedisin.

5 dhjetor 2023, Dita Ndërkombëtare e Tokës

Zhvilluam një orë mjedisore në shkollën 9-vjeçare “Mësonjëtorja e Parë Shqipe” lidhur me dy shpendë, të cilët gjenden në Parkun Kombëtar të Prespës, Pelikani Kaçurrel dhe Pelikani Rozë. Nxënësit u njohën me karakteristikat dhe të përbashkëtat e dy pelikanëve, përmes garës së kujtesës.

11 dhjetor 2023, Dita Ndërkombëtare e Maleve

Administrata e Zonave të Mbrojtura Korçë në bashkëpunim me Departamentin e Historisë dhe Gjeografisë, Universiteti “Fan S. Noli” organizuan një veprimtari në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Maleve e shpallur nga OKB-ja në vitin 2003. Si një ditë me rëndësi të madhe për zonat e mbrojtura 11 Djetori na kujton funksionet e maleve, ku, ato janë burim jete; duke siguruar ujin për bujqësinë, florën dhe faunën e egër. Në takim u fol gjërësisht për rëndësinë e maleve si një bazë e fortë për krijimin e ekosistemeve, duke sjellë vlera të mëdha të biodiversitetit, por nga ana tjetër edhe peizazhe tërheqëse për vizitorët e tyre.

12 dhjetor 2023, Orë mjedisore

U zhvillua një orë mjedisore në bashkëpunim me Shkollën Profesionale Teknike Korçë, me tematikë malet në rajonin tonë. Nxënësit u njohën me malet dhe rëndësinë që kanë në planet. Ora u mbyll me lojën “kush e gjen” ku nxënësit shpalosen njohuritë e tyre rreth maleve të qarkut tonë dhe në botë.

15 dhjetor 2023, Orë mjedisore

AdZM Korçë ka realizuar një veprimtari edukative krijuese me nxënësit e klasës së IV-ët, të shkollës “Omios”. Nxënësit krijuan kartolina për të përcjellë mesazhe për mjedisin, duke e konsideruar Vitin 2024 si “Viti i Blertë”. Në përfundim të aktivitetit, nxënësit mbollën disa fidanë gështenjë të egër (Castanea Sativa), në mjediset e oborrit të shkollës së tyre e, cila ndodhet në afërsi të hyrjes për në Parkun Kombëtar “Bredhi i Drenovës”.

“EDUKIMI MJEDISOR”, KUKËS



5 dhjetor 2023, Dita Ndërkombëtare e Tokës

Zhvilluam një orë edukative mjedisore, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e tokës, në shkollën 9-vjeçare “Novosej”.

7 dhjetor 2023, Orë mjedisore

Në kuadër të edukimit mjedisor me shkollat, stafi i AdZM Kukës zhvilloi një orë mjedisore në shkollën 9-vjeçare “Lek Qoka” Cërrnicë. Nxënësit u njohën me vlerat e zonave të mbrojtura dhe Parkut Kombëtar të Alpeve të Shqipërisë, si dhe kujdesin që duhet treguar gjatë ecjes në natyrë dhe male.

11 dhjetor 2023, Dita Ndërkombëtare e Maleve

Me nxënësit e shkollës 9-vjeçare Shishtavec “Kurora e Gjelbër e shkollës”, realizuam mbjellje në zonën e marrë në kujdestari nga kjo shkollë.

18 dhjetor 2023, Orë mjedisore

Zhvilluam një orë edukative mjedisore pranë Shkollës e Mesme “Asim Vokshi” Bajram Curri, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e maleve dhe biodiversitetit që ata kanë.

22 dhjetor 2023, Aksion mbjelljeje

Përgjatë datës 22 dhjetor, zhvilluam një aksion mbjelljeje, me qëllim rritjen e biodiversitetit në një zonë të eroduar, së bashku me shkollën 9-vjeçare “Kurora e Gjelbër e Shkollës” në Drogobi.



5 dhjetor 2023, Dita Ndërkombëtare e Tokës

Pranë nxënësve të shkollës 9-vjeçare "Besëlidhja" shpërndamë përrallën "Toka është flori", të cilën nxënësit e lexuan njëri pas tjetrit. Më pas fëmijët u pyetën për fragmentin më të bukur, duke e komentuar atë. Pasi nxënësit shënuan mendimet e tyre, së bashku, njëzëri vendosëm se cili ishte edhe mesazhi i përrallës.

12 dhjetor 2023, Dita e Lagunës së Patokut

Së bashku me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Adriatik" u zhvillua një orë mjedisore, në kuadër të Ditës së Lagunës së Patokut. Përgjatë orës nxënësit u njohën përmes një prezantimi me resurset e Lagunës së Patokut. Më pas fëmijët punuan në grupe dhe përgatitën postera me mesazhe sensibilizuese, për ruajtjen dhe mbrojtjen e lagunës së Patokut.

22 dhjetor 2023, Festa të Blerta

Së bashku me nxënësit e shkollës 9 - vjeçare "Nikë Tomë Prela" Gorrë u zhvillua një video, ku nxënësit përcollën urimet e tyre për një Vit të Blertë në vitin 2024. Atelia në shkollë, ishte një tjetër element shumë i bukur, për të cilën nxënësit ripërdoren materiale të ndryshme, me të cilat përgatitën kartolina, dhurata për njëri-tjetrin, ornamente për bredhat e shtëpive të tyre, dhurata simbolike për të afërmit, mësueset etj.



5 dhjetor 2023, Dita Ndërkombëtare e Tokës

Në kuadër të Ditës Botërore të Tokës (dheut) specialistët e AdZM-së Tranë realizuan një orë mjedisore informuese, me nxënësit e shkollës së mesme “Bahri Nela”, Zall-Bastar. Gjatë kësaj ore nxënësit morën informacion mbi tokën, përmes videos ilustruese; ku mësuam rreth profilit të tokës, llojet dhe përbërjen e shtresave të dheut, strukturën e secilës shtresë që bën dallimin dhe ndarjen midis tyre, si dhe faktorët që ndikojnë në ndryshimin e dheut. Nëpërmjet ushtrimeve ilustruese nxënësit përvetësuan më shumë njohuritë e marra për tokën. Në përfundim nxënësit u ndanë në grupe për përgatitjen e një miniprojekti, ku edhe përdorën materiale të marra nga natyra.

“EDUKIMI MJEDISOR”, GJIROKASTËR



5 dhjetor 2023, Dita Ndërkombëtare e Tokës

Me rastin e kësaj dite AdZM Gjirokastrë, ka zhvilluar një orë të edukimit mjedisor me shkollën “At Stath Melani” në fshatin e Petranit, Përmet. Kjo ditë synon të rrisë ndërgjegjësimin për rëndësinë e ruajtjes së ekosistemeve të shëndetshme, duke rritur inkurajimin dhe për të përmirësuar shëndetin e tokës.

11 dhjetor 2023, Dita Ndërkombëtare e Maleve

AdZM Gjirokastrë zhvilloi një orë mjedisore me nxënësit e klasës së parë “Urani Rumbo”. Fëmijët u njohën me rëndësinë e ekosistemeve natyrore të Zonave të Mbrojtura, me qëllim mbrojtjen dhe ruajtjen e natyrës bashkë me kashët e egra.

17 dhjetor 2023, Shpallja e Parkut Kombëtar “Bredhi i Hotovës Dangëlli”

Në kuadër të ditës së shpalljes së Parkut Kombëtar “Bredhi i Hotovës Dangëlli”, AdZM Gjirokastrë, me pjesëmarrjen e dashamirësve të natyrës të shkollës “Sami Frashëri” zhvilluan një aktivitet. Kjo ditë është e rëndësishme për të treguar rëndësinë që kanë drurët pyjorë në shërbim të ekosistemit të Parkut Kombëtar dhe detyrën për ruajtjen e trashëgimisë natyrore në brezat e ardhshëm. Vijuam me aktivitetin pranë qendrës së zyrës së informacionit me prezantimin e vlerave natyrore dhe kulturore të parkut, si dhe demonstruam kamerat e kurthit. Aktiviteti u mbyll këndshëm me vallet e performuara nga gjimnazistët e shkollës “Sami Frashëri”.

22 dhjetor 2023, Festa të Blerta

Me rastin e Viti 2024, viti i festave të blerta, AdZM Gjirokastrë, në bashkëpunim me ZVA Dropull-Finiq, zhvilloi një aktivitet me nxënësit e klasës së tretë të ‘Shkollës së Mesme të Bashkuar’ Dervican. Nxënësit vizatuan dhe krijuan disa kartolina, përmes të cilave përcollën dëshirat dhe urimet e tyre për vitin 2024.

“EDUKIMI MJEDISOR”, ELBASAN



5 dhjetor 2023, Dita Ndërkombëtare e Tokës

Në kuadër të “Ditës Ndërkombëtare të Tokës”, specialistët e AdZM Elbasan bënë të mundur mbjelljen e disa fidanëve në bashkëpunim me Bashkinë Përrenjas dhe nxënësit e Shkollës së Mesme të Bashkuar "Arif Kuka", Karkavec. Gjatë këtij aktiviteti nxënësit u njohën me mënyrën se si të mbjellim fidanë e të kujdesemi për to. Nisma të tilla shërbejnë si mënyra ndërgjegjësuere për brezat e rinj, për të përçuar tek ta dashurinë për natyrën si edhe për t'i afruar sa më pranë saj.

12 dhjetor 2023, Orë mjedisore

Specialistët e AdZM Elbasan, realizuan një orë të lirë mjedisore me nxënësit e Shkollës së Mesme të Bashkuar "Isak Alla" Zgoshit, pjesë e Parkut Kombëtar "Shebenik". Gjatë kësaj ore nxënësit u njohën me florën e parkut dhe vegjetacionin bimor. Gjithashtu ata identifikuan disa lloje bimësh mjekësore si: Trëndafili i egër (*Rosa canina*), Boronica (*Vaccinium myrtillus*), disa bimë endemike si: Zambaku Shqipëtar (*Lilium albanicum*), Sanza (*Gentiana lutea*) dhe lloje të tjera që gjenden në park si: Trumza (*Satureja montana*), Aguliçe (*Primula veris*) etj.

19 dhjetor 2024, Orë mjedisore

Specialistët e AdZM Elbasan realizuan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Sabrije Qyra" Dardhë, në afërsi të Rezervatit Natyror të Menaxhuar "Dardhë-Xhyrë". Gjatë kësaj ore, nxënësit u njohën me vlerat natyrore dhe mjedisore të rezervatit. Gjithashtu, ata u njohën edhe me faunën, duke identifikuar edhe disa prej tyre.

20 dhjetor, Festa të blerta

Specialistët e AdZM Elbasan realizuan një orë mjedisore edukative me nxënësit tek Shkolla e Mesme e Bashkuar "Rrahman Çota" Hotolisht, pjesë e Parkut Kombëtar "Shebenik". Në këtë prag festash, ata realizuan edhe disa kartolina me tematikë "Festa të Blerta- Viti 2024", duke përcjellë mesazhe urimi për vitin e ardhshëm, për të cilin urojmë të jetë një sa më i mbarë për pyjet dhe shtimin e sa më shumë hapësirave të gjelbra. Gjithashtu, në një kënd, nxënësit krijuan një galeri me foto nga disa aktivitete mjedisore siç është ai i pyllëzimeve, të cilët janë kryer nga ata gjatë vitit 2023.

22 dhjetor 2024, Orë mjedisore

Specialistët e AdZM Elbasan kanë realizuar një orë mjedisore me nxënësit e Shkollës 9-vjeçare "Asllan Shahini" Gramsh, në afërsi të Parkut Kombëtar "Mali i Tomorrit". Gjatë kësaj ore u njohën me vlerat natyrore dhe mjedisore të parkut, si edhe me florën dhe faunën e tij. Gjithashtu ata u njohën edhe me monumentet e natyrës, të cilat ndodhen në territorin e Bashkisë Gramsh, që administrohen dhe menaxhohen nga Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura Elbasan. Orët mjedisore kanë si qëllim përcimin e njohjes, promovimit të vlerave të bukurove natyrore dhe mbi të gjitha përcimin e dashurisë për natyrën tek brezat e rinj, një temë e cila është me shumë interes për nxënësit.

